

**Njoftim për përqendrim me të cilin MKG PROPERTIES LTD, Limasol, Qipro, dhe
TERRAMONA HOLDINGS LIMITED, Nikozia, Qipro, do të fitojnë kontroll mbi
BATTING LIMITED, Limasol, Qipro**

(lënda nr. 08-141/2025)

Në pëpruthje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 30.09.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin MKG PROPERTIES LTD me seli të regjistruar në 3, Krinou Street, THE OVAL, Office 502 Agios Athanasios, CY-4103 Limasol, Qipro, dhe TERRAMONA HOLDINGS LIMITED me seli të regjistruar në Andrea Vlami 6, Strovolos 2008, Nikozia, Qipro, do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi BATTING LIMITED, me seli të regjistruar në Griva Digeni 115, Trident Centre, 3101 Limasol, Qipro.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe veprimtaritë e tyre afariste:

MKG PROPERTIES LTD është pjesë e grupit MK dhe paraqet një shoqëri holding e cila menaxhon divizionin e grupit MK aktiv në sektorin e turizmit, përkatësisht në fushat e hotelerisë në Serbi, Kroaci, Mal të Zi dhe Slloveni.

Grupi MK është i pranishëm në Maqedoninë e Veriut përmes shoqërisë së varur MK Suntastic SHPKNJP Shkup, me seli në adresën bulevardi Partizanski Odredi 155/1, Shkup, nr. regjistrimi 7838034.

TERRAMONA HOLDINGS LIMITED është një shoqëri qipriotë e themeluar në korrik 2024 dhe deri më sot nuk ka kryer asnjë veprimtari afariste. Shoqëria është themeluar kryesisht me qëllim të investimit të kapitalit në shoqëri, veprimtaria kryesore e të cilave është ndërtimi, zhvillimi dhe blerja e pasurive të paluajtshme në Serbi dhe vendet e tjera të rajonit.

TERRAMONA HOLDINGS LIMITED nuk gjeneron të ardhura në Maqedoninë e Veriut dhe nuk ka asnjë prani përmes shoqërive të varura, filialeve apo përfaqësive.

BATTING LIMITED është një shoqëri holding, pronësia e së cilës përbëhet nga 100% pjesëmarrje në shoqërinë Instituti për Ndërtim shpk Beograd, me numër amë 21435732.

BATTING LIMITED nuk gjeneron të ardhura në Maqedoninë e Veriut dhe nuk ka asnjë prani përmes shoqërive të varura, filialeve apo përfaqësive.

Sipas parashtruesit të njoftimit, tregu relevant për përqendrimin në fjalë mund të përkufizohet si tregu i menaxhimit të pasurive të paluajtshme.

Në bazë të hetimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bien nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të dorëzojnë vërejtje dhe mendime për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose me e-mail:

kzk@kzk.gov.mk dhe ato duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

02.10.2025

Shkup